ADEM ZAPLLUZHA

TELAT E SHIRAVE

Redaktor:
Vilson Culaj

Recensent:
Vilson Culaj

Lektor:
Veli Veliu

ADEM ZAPLLUZHA

TELAT E SHIRAVE

“TREND”
2017

UNIVERSI LETRAR NË DRITËN E NJOHJES SË ADEM ZAPLLUZHËS

Vështrim për librin poetik të Adem Zaplluzhës ,, Telat e shirave ,, Botoi TREND Prishtinë - 2017

Mr. Vilson Culaj

Poeti dhe krijuesi i mirënjohur në opinionin letrar dhe atë mbarëshqiptar, Zotëri Adem Zaplluzha, i prezantohet lexuesve tanë me librin e tij të 151 - të me radhë, jo vetëm si një masë renditëse , por masë kualitative e një bote të pasur letrare për ta shpërfaqur edhe njëherë Erudicionin e tij letrar krejt natyral, esencial dhe ekzistencial të një shpirti gjallues i cili shpirt e mendje di të përceptojë, rezonojë, dhe krijojë vlera të mirëfillta poetiko – letrare .Ato lidhen direkt me gjeo - përceptimet e tij metafizike dhe dialektike të vlerave të gjithëmbarshme të etnosit tonë, por edhe të përvojave të tij personale që shpeshherë dinë edhe të mahnitin për vlerat e tyre ideo – artistike. I të njëjtës përmasë na ofrohet edhe ky libër poetik ,, Telat e shirave ,, metaforë e kryetemë e ligjërimit

poetik e cila mban në bërthamën e saj një jetë gjakim e reminishencë për dashurinë ideale ,zhytur thellë në kohë diku në kataraktet e shpirtit të poetit...

Diskursi letrar e poetik i Adem Zaplluzhës është sa universal,po aq personal dhe nacional të cilat kur të ngërthehen e zbërthehen në art të mirëfilltë letrar, krijojnë një origjinalitet krijues krejtësisht unik, për dallim nga mëtuesit tjerë për të qenë poet cilësor. Ja si shprehet poeti falë dimensionalitetit të tij krijues : “Unë nuk jam Krishti, ama as ti Juda, por sot disa herë me radhë, mashtruam njëri-tjetrin...Autori synon dhe arrin që çdoherë të jetë sa më objektiv dhe origjinal, korrekt, human, shumëdimensional,edhe qortues, por jo i tipit shtiracak veshur me një petk mistik Altruizmi sa herë që trajton temat e mëdha dhe të përbotshme ‘’Dashuria dhe Dhimbja’’, të cilat i fokuson në dritën e frymëzimit poetik. Ai njëherit nuk lë pa u futur edhe në trajtime të natyrës sociologjike, filozofike, teologjike, psikologjike, etnike, duke i shkrirë të gjitha në një terezi unike poetike dhe letrare, falë edhe përvojës së tij të begatë jetësore. Ky shtegtim magjik dhe marrjet nga jeta e etnosi e logosi, e bëjnë autorin Zaplluzha njërin ndër zbërthyesit më të veçantë të herezive e hipokrizive tona,

destruktiviteteve e molisjeve artistike e kulturore, por edhe të maskave letrare e shoqërore. Pra, letërsia e Adem Zaplluzhës është përvojë e tërësisë shoqërore e personale e cila merr kuptim gjatë procesit të ballafaqimit dhe zgjidhjes së problemeve përmes ,, armës ,, ideo – poetike, falë aftësimit të tij letrar në dekada dhe ngritjes së tij racionale dhe shpirtërore. Poezitë e z. Zaplluzhës shquhen për disidencën,konceptine e lartë letrar,metrikën,metaforën,antitezën,krahasimin,personifikimin,simbolikën,sarkazmën,ironinë dhe mesazhet e qarta metakohore , falë përvojës së tij të madhe letrare e jetësore që e kanë shtyrë autorin t'i kapë e përceptojë esencat gjatë shtegtimit e ballafaqimit të tij me Bizantinimat e Simonizmin tonë letrar e sociologjik, ku në këtë rast na del edhe si një model letrar që di t'i vlerësojë hapat e tij të vetëdijshëm jetësorë, vlerat universale, por edhe kohën të cilën di ta shfrytëzojë në mënyrë produktive. Autori përmes reflektimeve letrare nuk do ta ngufatë, instalojë , as kushtëzojë jetën,artin e tij,e as të të tjerëve, nëpërmes kontrollit e ndikimit të epërsisë, por zëri i tij kritik e artistik është i veshur me petkun e parimit, të gjykimit të shëndoshë logjik dhe mesazheve ideo-artistike e letrare për një botë ,, që di e duhet të ecë në këmbë të shëndosha,, . Autori ligjëron e alarmon përmes

vargut të konsoliduar dhe plot vlera për : heshtjet e kukuvajkave, zërin e nëntokës, mëkatin e lindur, hapësirat e boshatisura, orën e vjetër, detyrat e çmendura, mbufatjen e lumenjve dhe qiejt e zi në detin pa diell. Reflektimet në këtë libër, por edhe te librat tjerë pararendës, autorin e rendisin si mjeshtër të metaforës, simbolit, e figuracioneve meta – ideore si : koha kur vdiste dielli, u thyen si kashta, Juda mohonte diellin, stinët mbetën pa formë, varkat u fundosën, zvarranikët parahistorikë, mallkimet po u ngjajnë perëndive, çatitë e skamnorëve, pemët delikate, shurdhimi i ajrit, gjumi i vdekjes,etj; metafora jo të rëndomta, por as të lehta e të arritshme, që vetëm mendja universale e autorit di t'i ndërtojë, ideojë, e jetësojë, por edhe t'i plasojë në gjeografinë letrare mbarëshqiptare. Autori përmes brumosjeve të shprehive kontemplative poetike ngreh zërin e revoltës që : misionin tonë personal, shoqëror e atë nacional ,, mos ta zë gjumi i injorancës, miopisë, përçarjes, destruktivitetit e regresit, por përmes dritës së njohjes të njohjeve personale e kolektive të shtegtojmë drejt shtigjeve të iluminizmit e progresit kombëtar. Kërkesa e uni i tij letrar është aq human dhe i natyrshëm; vetëm kërkohet vesh shpirti për t'u dëgjuar. Autori shquhet për zbërthimin e esencave dhe detajeve jetësore ku përmes vargjeve

poetike shpreh etjet e gjakimet e tij personale për barkën e jetës, bukën e dashurisë, amën e bërthamën shpirtërore, arratisjen e gëzimeve, dhe lumenjtë e kujtimeve që çdo ditë e grishin përpara pasqyrës reminishente dhe thinjave fisnike në kokë. Pra, poeti përvojën e tij Empirike di ta shndërrojë në art të mirëfilltë letrar dhe me mjete artistike zbërthen figurën mitike të Sizifit modern. Arti letrar i Adem Zaplluzhës rrjedh e buron nga shpirti që është i mbushur me shpirt e dije, dhe atë margaritar shpirtëror e dije artistike,ai di ta plasojë e shpërndajë tek lexuesi ku këto tri rruzullime vlerash në mënyrë ciklike vezullojnë përballë frymëzimeve poetike të autorit.

Në ciklin e dytë të librit ,, Vdiqën edhe mrekullitë që quheshin ëndrra ,, autori përmes mjeteve letrare shqyrton për fenomenologjinë e kohës, hapat jetësorë, reminishencat personale, e këngët pa këndime, ligjet e gjakosura të hakmarrjes, varret pa kryqe, plagët pelin, e kohërat e liga të cilat autorin e ,, vrasin ,, në brendi ,mu si pritja e tij. Këtu shpërfaqet edhe një cilësi ekstra e autorit: njohuria historiko – poetike, sepse autori ndjen një parandjenjë se i takon të kaluarës , të tanishmes dhe së ardhmes historike e letrare, por edhe asaj etnike. Kjo situatë refleksive e letrare na mbërthen

e dërgon tek thënia e njohur e Nobelistit Rus Solezhnic ,, Ai që e harron të kaluarën ju thafshin të dy sytë ,,. Ja si shprehet poeti Zaplluzha lidhur me këtë fenomenologji historike dhe harresën tonë kolektive:

Nëpër qytete vdisnin meshat...
Ua kthyem shpinën gjyshërve..
Na varrosnin pa Kryq e nishan...

Këtë kryq e vuajtje si duket e ka përjetuar edhe autori përgjatë jetës së tij, por në heshtje, andaj shkëndijat e përcëllimet e tij letrare, ideo–mesazhet, vlimi shpirtëror, struktura e vargut dhe ekuacionet poetike e logjike si dhe refleksionet trumbetuese e pa pardon, vetvetiu tek autori shndërrohen në moral dhe arsye njerëzore. Me këtë petk të vlerave, s'duket ka dëshirë autori ta shoh kombin e tij të përndritur, human, punëtor, të integruar e vizionar e jo të mbërthyer në ,, kryqin e kohës ,,.

Pra, autori nuk ka rrugë tjetër përveç se të klithë në ,, shkretëtirë'' sepse bota e tij ekspresive e poetike nuk e do hipokrizinë; përkundrazi, ato e tundojnë. Ai ka dëshirë që eksperiencat e gjakimet e tij për një jetë më të dinjitetshme kolektive si dhe vizionet e

qarta, t'i tërheqin drejt këtij shtegu të përndritur. Poezitë e lirikës atdhetare të krijuesit Zaplluzha janë aq të përthelluara, fine, artistike, shqyrtuese, meditative, deiluzive, përmbajtësore dhe të zhveshura nga ,, petku i kultit ,, por njëherit të mbështjellura edhe me margaritarin e ndjesisë e empatisë bujare- si një lloj vetëdije poetike, nacionale. ,, Unë di nga rrjedh dhe cilit popull i takoj''- shprehet poeti vizionar në këtë rast. Prekja e realitetit objektiv e real e jo ushqyerja e iluzionit, janë veti e cilësi e poetit në këtë rast. Ai nuk i do flijimet as dhuratat në tempuj përpara mëshirës e humanizmit. Dhe përpara se t'i dhurohet botës e poezisë, së pari kërkon pajtimin shpirtëror me vëllanë njeri. Dhe nëse mitikja lindi si rezultat i harresës, poeti Zaplluzha vepron në të kundërtën e erërave pa adresë. Ai di të mendojë, të shkruajë, rezonojë, të japë mesazh letrar, por edhe të njësohet me artin dhe pikëpamjet e tij të shëndosha. Lufta për autorin është absurdi më primitiv i racës njerëzore, edhe pse ai di t'i çmojë dhe thurë lavde vetëm luftëtarëve të lirisë sonë. Atdheu i tij poetik dhe territorial jeton brenda tij, dhe as kryqëzimet e as ngritjet në Olimp, por as miti i Gjergj Elez Alisë e as kanunet, nuk e zmbrapsin nga misioni i tij fisnik:- poezia. Më një fjalë, poeti Zaplluzha nuk di ta ,, tradhtojë atdheun e tij ,, që

buron nga dija e frymëzimi fisnik. Falë stoicizmit të tij letrar në dekada, poeti arrin edhe në stadin e tretë të ekzistencës...pra pjesën e tretë të librit dhe ngreh kumtin human ,, ju thashë se vdekja nuk ekziston në mua,, Këtu në fakt qëndron edhe lajtmotivi i poetit. Ai nuk do që të mbetet ,, druri lakuriq i botës ,, por do që të shndërrohet në pemën frytdhënëse që i zotëron kohërat. Siç duket, krijuesi Adem Zaplluzha si kush më mirë ka ditur ta perceptojë maksimën e artë se : ,, Koha është përgjegjësia ime,, dhe rrallë si ai kanë ditur që për kaq dekada t'i shërbejë jetës, progresit, kulturizimit, artit e poezisë dhe kulturës poetike shqiptare në përgjithësi.

Autori ka përjetuar paqen, luftën e lirinë njëkohësisht dhe aq bukur ka ditur ta kuptojë realitetin e jetës e botës, ku prapë është i gatshëm çdoherë të ballafaqohet prapë me këto të tria dhe t'u shërbejë njëkohësisht prapë atyre...

Cikli i parë

Telat e shirave

VENDOSI DY FLETA TË MYKURA GJETHI

Unë nuk jam Krishti
Ama as ti nuk je Juda
Por sot disa herë me radhë
Mohuam njëri-tjetrin

Të thashë
Të lutem mos hezito
Vendosi dy fleta të mykura gjethi
Vendosi mbi varrin tim

Është vjeshtë e vonë
Ose dimri veç po i tregon dhëmbët
Shiko përreth teje
S'paska mbetur asnjë gjeth i fishkur

Kjo dhembje po i thyen edhe gurtë
Si t'i shëroj plagët
Me cilin melhem ta lyej dhembjen

Që të mos i dëgjohet britma

Po më ngufat frymëmarrja
Ku ta gjej kryqin tim
O të lutem më trego
Ku ta vendosi këtë dhembje që s'ka shërim

TELAT E SHIRAVE

Po këputen
Trishtueshëm po këputen
Telat e shirave
Nga cila copë mjegull
Po bie ky qiell mbi kokën time

Kjo moshë e sfilitur
Qëndron rënduar mbi shpatullat e mia
Për cilën dhembje të mbështetem
Ku të kërkoj derman
Në cilën përrua t'i varrosi eshtrat

Asnjë hap s'mund të eci para
Por as mbrapa s'dua të shkoj
Çfarë të bëj me vetveten time
Sa herë e pështy qiellin
Më qullosen flokët e thinjua

Mos të lutem mos më ngacmo

Në këto çaste delikate
Jam tepër i lodhur
Si mund ta duroj këtë dhembje
E cila trishtueshëm rëndon shpirtin tim

Prishtinë, 29 nëntor 2016

HESHT MOJ KUKUVAJKË

Pa reshtur po bien mjegullat
Po bien perënditë
Nga telat këputura të qiellit
Mbi varret e qytetit
Po bien shirat e mykura të një kohe

Këto vrizma dhembjesh
Nuk paskan të ndalur sonte
Ku ishe ti
Kur e verbuan diellin
Sa pika gjaku spërkatën shpirtin

U thyen edhe shtambat e thyera
Si ta shuaj etjen
Kur kjo dhembje e pashpirt
Po i gërryen
Muret e rrënuar të kujtesës

Hesht moj kukuvajkë

Me zërin e cilit trishtim
Po i këndon sonte
Këngët e shkundura të dikurshme
Hesht si shpirti lapërdhar i erës

Prishtinë, 30 nëntor 2016

NJË ZË BURON NGA NËNTOKA

Janë shurdhuar njerëzit dhe pemët
Një dyllë i verdhë
Çurgon nga shpirtrat e thyera të degëve
Mbase edhe janë verbuar
Nuk i shohin
As si dëgjojnë klithmat e shpirtit tim

Një zë buron nga nëntoka
Buron mbështjellë me dhembjen
Ku mbetën duart e mjegullave
Kur në telat e këputur të shirave
Pushojnë shtrezet
E një kohe kur vdiste dielli

Mos mi prekni thinjat e flokëve
Po thyen si kashta
Po bluhen kujtimet e kaluara
Duke e përmbytur të sotmen
Një qyqe e zgërlaqur
Vajtueshëm këndon një serenatë të vjetër

SHKELIM MËKATIN E LINDUR

Përse aq shumë mëshirë
Orë e çast
Kërkojmë nga Hyji
Nëpër rrugët e baltosura
Shkelim mëkatin e lindur
Dhe përbuzim atë të vdekur

Sa herë në ditë njeriu e gabon
Rrugën e vet
Ndalet në një skutë të rrënuar
I drejton sytë kaq qielli
Kur në mendje i sillen mëkatet
Shikon hapësirën e boshatisur

Në shuplakat e veta
I kërkon fijet e këputura të penjve
Sërish i drejton sytë kah qiell
Mjegullat e mrrolura azdisen
Azdisen si kuajt e paçjerrë
E lutjet nuk paskan të ndalur sonte

ORA E VJETËR

Në dhomë acar i paparë
Shtatë qirinj të verdhë
I ndezëm sonte
Një flutur krah këputur
Si Juda mohonte dritën

Nuk di cili muaj ishte
Por dimri nuk dukej askund
Nuk është as verë e as vjeshtë
Në dyshemenë e ftohtë
Shtruam iluzionin e një fjale

Kurrë më nuk u ndalën sazet
Dajret dëgjoheshin
Në shtatë mëhallë
Në degët e secilës pemë të kalbur
Këndonte nga një kumri i lagur në shi

Stinët mbetën pa formë dhe shpresë
Trenat endacakë
S’dihet se kur i harruan itineraret
Ora e vjetër në stacionin e vetmuar
Me habi shikon orientimin e kohës

NUK DI SE CILA KOHË ISHTE

Hesht më
Zbrit nga ai fron i mohimit
Të rrallë janë njerëzit
Që mohojnë identitetin e vet

Të kujtohet vjeshta
Ose dhjetori që e hapën plagën
Hesht po të them
Ti nuk i beson as vetvetes

Në çastin kur e prenë bastardët
Kokën e pulës së sëmurë
Të gjitha pranverat

U përmbytën në gjol

Nuk di më se cila stinë ishte
Por ishte një kohë
E cila mbi mbeturinat e kujtesës
I lë peng dhembët që ende kundërmojnë

DETI I ÇMENDUR LINDTE NJË
TJETËR DET

Më duket se ishte vështirë
T'i dallojmë ngjyrat
Mbi një basma të vjetër
Shiu i tejdukshëm
Ngjante me njollat e gjakut

Unë kurrë nuk i dallova ngjyrat
E kaltra me dukej
Se kishte një shije të verdhë
Ti me kokëfortësinë tënde
Rrije ulur mbi qilimin e gjelbërimit

Çdo gjë më dukej e gjelbër
Atë ditë
Mjegullat në hapësirë tundeshin
Si varkat e fundosura
Tundeshin mbi dallgët e ndërgjegjes

Asgjë s’dëgjuam
Përpos shtërzimit të brigjeve
Deti i çmendur lindte një tjetër det
Aq afër ishte qielli
Sa që nga kujtesa piu disa gllënjka mllefi

SA HERË QË MBUFATEN LUMENJTË

Për çudi
Si ushejzat e zeza
Ose më mirë me thënë
Si zvarranikët parahistorik
Po na kalojnë ditët

Ndoshta kemi harruar t’i përkujtojmë
Ikjet e stinëve
Vjeshta më
Nuk i përngjan vjeshtës
Sa shumë u ngjan lakuriqëve të natës

Sa herë që mbufaten lumenjtë
Nga shpirtrat e brigjeve
Si nga ndonjë përrallë
Dalin rrugëve dinozaurët
Dalin duke i imituar ecjet e tendosura

Sa herë që patëm nevojë
Shirat kurrë nuk erdhën këndej
Iknin nëpër lagjet e evgjitëve
Dhe gjatë tërë kohës
Deheshin si drurët e moshuar

NË AGULLIMË T'I ZGJOJMË TË VDEKURIT

Në këtë qytet mallkimet
Si shirat po bien mallkimet
Ose po u ngjajnë perëndive
Që s'ditën asgjë tjetër
Përpos të na mashtrojnë e mallkojnë

Nën çatitë e skamnorëve
Dëgjohen disa zëra të çuditshme
Dëgjohen ndoshta thirrmat
E gjyshërve të kamur
Por gjithsesi zërat nuk mejnë

Më kujtohet kur isha adoleshent
I shkundnim kumbullat
Ftonjve të egër
U lidhnim nga një spango të kuqe
Dhe pritnim pjekjen e tyre

Kështu na patën mësuar gjyshërit
Thoshin se duhet t'u ngjajmë këndesave
Në agullim t'i zgjojmë të vdekurit
Se për ndryshe për çdo menatë
Breshëri i zi na i thyen xhamat

TË ZI E PATE DIELLIN E QIELLIN

Mej moj qyqe e çmendur
Mej shtrembake
Në vend se të këndosh
Njëqind vjet kukate
Të njëjtin vajtim

Tregonte im gjysh
Për ardhjen tënde në këto troje
Erdhe me një lopë
Dhe pelë të zgërlaqur
Parmendën e huazuar kurrë se ktheve

Mej he të vraftë i madhi Zot
Ti cilin si gjithmonë
Nga njëqind herë në ditë e shanë
E shanë sepse shumë vonë kuptove
Ose se pranon ekzistimin e tij

Të thashë mej moj degë e këputur

Kukuvajkë e zezë
Të zi e pate diellin e qiellin
Nga barku i nënave
Shkule sa e sa shpirtra njomëzakësh

Prishtinë, 1 dhjetor 2016

KËNDOJNË EDHE ÇAFKAT E BARDHA

Të qëndrosh brenda në thëllim
Ta ndjesh dimrin
Dhe vajin e dëborës që pjalmon
Kurse në korridor
Një diell i çmendur hungëron

Ti nuk je më askund në hapësirë
Noton në ajrin e ndotur të kujtesës
Në oborr të pjek dielli
Kurse në dhomë
Fërfëlliza fryn nga të katër anët

Kush i preki gishtat e stinës
Në azilin e pleqve
Mbrëmë hynë shtatë arkivole të verdha
Shtatë herë këndoi qyqja
Mbi një varr të vithisur te plepishtat

Zëri im i mekur pa nota
Këndon një serenatë
Këndojnë edhe çafkat e bardha
Shih paska filluar dyndja e zogjve
Një njeri i vetmuar i ndezi qirinjtë

SËRISH I KREH FLOKËT E THINJURA

Zgjohesh nga një jerm i çuditshëm
Në pasqyrë përballë tualetit
I rregullon flokët e mëngjesit
Në ndërgjegje
S'të mbetet asnjë ëndërr

Me pallton tënde të zezë
Si pa kokë del nga shtëpia
Në tavernën e parë
Rrufitë kafen farmak
Dhe nisesh tatëpjetë kujtesës

Në fillim ose në fund të shkallëve
Të pret një udhë e gjatë
Sërish i kreh flokët e thinjura
Rruga për ku ke marrë udhë
As për shtatë vjet nuk mund të mbërrish

PEMËT DELIKATE

Kjo hënë pa asnjë degë
Qenkan fishkur edhe gjethet
Ku do të pushojnë zogjtë endacakë
Kur kthehen në pranverë

Në varre nuk shkojnë më njerëzit
As barinjtë s'shihen andej pari
Vetëm era e lazdrake
I ledhaton fijet e këputura të barit

Afër njëqind vjet këtu nuk bie shi
As dimri s'ishte këndej pari
Pemët delikate

Po ushqehen me rrënjët e vdekura

Mbrëmë pashë një zhapik të verdhë
Duke pirë lotin e vet
Etja ishte aq e madhe
Sa që vdesin edhe rrasat e murrme

KY SHURDHIM I AJRIT

Shiu më s'troket në xhama
As era nuk fryn
Në dhomën e acartë të ditës
Dielli me thera na i shpon sytë
Kjo vjeshtë e vonë
Në mes të rrugës po i thyen gishtat

Thyhen edhe drurët
Të lehurat e natës kurrsesi s'pushojnë
Një udhëtar të vetmuar
Ndoshta për herë të fundit
E paska zënë gjumi
Pranë faltores së Shën Mërisë

Poshtë në tokë
S'kanë ku të shkelin këmbët
Qielli tepër lart
S'dëgjohen lehjet e yjeve
Ky shurdhim i ajrit
Mbase po i verbon zogjtë në fluturim

KUR NA ZË GJUMI AI I VDEKJES

Kur na zë gjumi ai i vdekjes
Gjërat që ne deshëm ose jo
Presin në rreshta të gjata
Të vijnë në vendin e vet
Pastaj platiten mu si zjarret
Platiten të mos digjemi si qirinjtë

Kur na zë gjumi
Nëse mund t'i themi gjumë
S'reshtin mysafirët
Në rreshta të gjata që u ngjajnë mëkateve
Në fund të rrugës na presin makthet
Vijnë edhe ata të përroit të zi

Kur na zë gjumi ai i vdekjes
Ne veç i kemi larë duart
Në një skutë të oborrit
Mbështetur për manën e zezë
Na pret qivuri
Po nga ai lloj druri që e mbollëm

MOS THUAJ ASNJËHERË JO

Mos thuaj asnjëherë jo
Dritat e neonit mbi asfaltin e lagur
Për çdo mbrëmje kyçen
Kurse herët në mëngjes shkyçen

Sa shumë ngjajnë me varkat
E peshkatarëve të vetmuar
Në mëngjes humbin diku në thellësi
Që në mbrëmje të kthehen të lodhura

Mos thuaj asnjëherë jo
Sa herë që lind dielli metaforik
Po aq herë fundoset etja
Në shpirtin e pafund të perëndimit

Mos thuaj asnjëherë jo
As në ëndërr
S'guxon të bisedosh me makthet
Sepse ata për çdoherë kthehen

Mos thuaj asnjëherë jo
ASKUSH ASNJËHERË NUK KUPTOI

Thanë se ishin dymbëdhjetë kalorës
Njëri që në fillim
E mohoj njeriun
Mbetën njëmbëdhjetë
Vetëm kali i të mohuarit
Me shekuj hingëllon yjeve që këputen

Askush asnjëherë nuk kuptoi
Athua vallë
Ai i dymbëdhjeti
I takonte gjinisë njerëzore
Ishte ndoshta një gabim
I cili kurrë nuk u përmirësua

Dhe zuri fill mohimi i së vërtetës
E shikonte në sy njeriun
Dritën dhe mikun
Mohonte sofrën e shtruar
Bukën e dashurisë
Mohonte bile edhe vetveten

Njeriu dhe mohimi në parakalim
Më pastaj vjen ndërgjegjja
E cila si një plagë e pashëruar
Për çdo natë e ditë
Troket në xhamat e palara të shpirtit

NE ENDE JETOJMË NË STERRË

Domosdo më duhet ta ndryshoj mendimin
Si pate durim
Që s'fole asnjë fjalë
Kur të shikoja në sy
Kurse ti kaloje në heshtje
Duke mohuar dritën që lindte

Po të mos ekzistonte mohimi
Ne edhe më herët
Do të dilnim në dritë
Ndoshta që nga ai moment
Errësira u fundos në shpirtin e njeriut
Dhe ende jetojmë në sterrë

Nuk kuptoj përse nuk ja zure
Kafshatën e parë në grykë
S'bëzane
Por lejove
T'i lëshoj rrënjët e pista
Mohimi i një drite e cila veç kishte lindur

ARRATISEN TË GJITHA GËZIMET

Ajo ecën pa menduar
Vrapon në kahe të kundërt të shirave
Në atë ekstazë
Si e dehur dëgjon hungërimën e natës
Nga sytë e saj të gështenjtë
Rrufeshëm derdhen lumenjtë e kujtimeve

Ajo ecën si askush tjetër
Ecën në drejtim të akrepave të orës
Kur është e pikëlluar
Nga shpirti i saj delikat
Arratisen të gjitha gëzimet
Vetëm e kaluara i kërkon rrënjët e humbura

Në secilin hap mbjell nga një lule
Sa herë që shkel manaferrat
Nën shputat e saja zgjohet
Dielli i fjetur i adoleshencës
Fillon me dënesën e para
Kurse ajo e fundit asnjëherë s'përfundon

RRI VARUR PORTRETI I SHTHURUR I ERËS

Kjo egërsi delikate
Me furi depërton nën lëkurën e atdheut
I hapi sytë
Shoh se si enden fluturat e plagosura
Pranë zjarrit që s'shuhet
Në shpatullat e këndesit shikojnë vdekjen

Nën raftin e librave
Ai e mbante pushkën e gjyshit
E mbante varur
Portretin e shthurur të erës
Ti në ato çaste shikoje diellin
Një zot e di
Se në cilin udhëtim je nisur

Por ti gjithsesi i besoje lirisë
Je aq afër meje
Po aq sa je larg prej vetvetes
Shtrati i vjetër përjeton katarzën
Nga sytë e tradhtisë o vëlla Zahir
Shkrepin disa xixa drite për të nesërmen

NDOSHTA MË HARRON KY GUR I ZI

Je grua shtat selvi
Po aq delikate si pikturat
E Mikel Angjellos
Çfarë të bëj me lëkurën tënde
Me cilën gjilpërë ta arnoj dhembjen

Askush nuk më kupton
Gurin që e mbolla në zemër
Tani peshon sa ai i Sizifit
Sa herë që dua ta largoj
Po aq herë fundosem në dheun e shkriftë

Si të shkoj përtej gurit
Çfarë të bëj këndej murit
Kjo plagë që s'shërohet sot
Me asnjë melhem
S'mund të mbyllet nesër dot

Mos të lutem mos më zgjo
Nga kjo vdekje e keqe
Me lër të fle më së paku njëqind vjet
E kur të zgjohem
Ndoshta më harron ky gur i zi

TANI ËSHTË DIMËR

Pritë edhe pak
Pritë sa të vdesin të gjitha lulet
Ndoshta atëherë
Zgjohet një pranverë e re

Por është e pamundur
Ata që shkuan
Si mund të kthehen në vjeshtë

Tani është dimër

Kudo nëpër rrugët e baltosura
Më kafshon acari i zi
Pjalmi i borës së kuqe
Laracon çatinë e thyer të shpirtit

SI TË DALË NGA KJO AMULLI

Ky pasion që djeg e përvëlon
Në trurin e drurit të kalbur
Mbolli farën e dyshimtë
Mbolli drurin
Në palcën e ashtit të thyer

Unë më nuk jam unë
Dikush befasisht
Hyri në qenien time
Dhe tërë kohën i dëgjoj
Të lehurat e qenve endacakë

Si të dalë nga kjo amulli
Angështia me dorën e saj katran
Po i ngacmon qemerët e shpirtit
Orë e çast
Po qahen kasnakët e mallkimit

Ju thashë se unë më nuk jam unë
As nuk di se kush banon në mua
Cili djall më fton në bejleg
Me çfarë arme do qëndroj përballë
E pastë mallkimin prej saj

ZBRIT E TË HUMBTË FARA E FISI

Çdoherë të shoh ulur kacule
Në të njëjtën degë
Zbrit njëherë o korb i zi
Tepër shumë
Kullote mbi trishtimet e njerëzve

Zbrit nëse ke fytyrë e kaçik
Ulu pranë ndërgjegjes tënde
Dhe burrërisht pyete atë ego të sëmurë
Trego sa herë ishe njeri
E sa herë për pekule u shndërrove në Judë

Zbrit e të humbtë fara e fisi

Ti or Judë i ringjallur
Besoj se ende i dëgjon lehjet e tua
Ose ta kanë futur kokën në gjiriz
Ku nesër do të të kundërmoj ardhmëria

Prishtinë, 2 dhjetor 2016

Cikli i dytë

Vdiqën edhe mrekullitë që quheshin ëndrra

KU SECILI PIKTURON ËNDRRËN E VET

Një kohë të gjatë
Ndoshta me mija vjet
Dhe ende vazhdon avazi i njëjtë
Copa e shtrydhur e argjilit
I ngjante qeshjes së njeriut

Për çudi deltina në duart e mia
I kishte disa lloje ngjyrash
Po ato ngjyra
Që i kanë sot njerëzit nëpër xhepa
Ku secili e pikturon ëndrrën e vet

Kurse argjila në duart e mia të rrudhosura
Jeton pa asnjë ëndërr
Nga sytë e saj të portokalltë
Lindin të gjitha mrekullitë
Lindën guaskat gjysmë perëndi

Sa herë që fundosem
Në shpirtrat e anijeve të vdekura
Thellë në palcën e gurit ndjej
Britmat e fanarëve
Ndjej se si lindin sirenat e kujtesës

THONË SE KURRË NUK E NDALI FLUTURIMIN

Më herë moti më treguan gjyshërit
Se nga një pjesë e këtij rrapi
Gdhendën djepin tim
Gdhendën edhe dykrenorin
I cili s'dallohej nga perënditë

Ende më kujtohet një këngë e vjetër
Që i ngjante qëndresës
Mbase edhe gurit
Sepse ajo asnjëherë nuk u zhduk
E as s'u thye gjatë fluturimit

Ishte si sfinksi i shkretëtirës
Etjen e duronte më shumë se rëra
Sa herë që fluturoi hapësirave
Nga secila baladë
Huazonte nga pak prej së nesërmes

Thonë se kurrë nuk e ndali fluturimin
Ende sot fluturon mes stuhive dhe zjarreve
Sa që në secilin fluturim
Takohet me shpirtin e pavdekshëm të erës
Që lind dhe jeton për të nesërmen e madhe

NËSE NE MUNGOJMË

Nëse ne mungojmë
Pranë nesh si në procesion
Parakalojnë stinët
Dukemi si shurdhmemec
Asnjë kalimtarë nuk e kupton heshtjen tonë

Nuk e kuptojmë as ne
Sepse mungesa e jonë përzihet
Me ajrin e ngrirë të kujtesës
Pastaj u ngjajmë përmendoreve
Pranë të cilave urinojnë qentë endacakë

Nëse ne mungojmë nëpër xhepat tona
Mbin shkurret
Dhe manaferrat e të gjitha llojeve
Nëse ne mungojmë në mungesën tonë
Asnjëherë s'takohemi me vetveten

KURSE DIELLI I COPËTUAR

Këto pak gjëra me duket se posedojnë
Ngjyrën delikate
Të portokajve të pjekur
Rrënjët paskan mbetur jashtë
Hapësirës së kujtesës

Ngjajnë me shtatë yje të këputur
Nga sfondi i pafund
I imagjinatës
Kurse dielli i copëtuar
Si flamujt e atdheut i shkund mendimet

Afër gardhit të shembur
Thahen këmishët e gjakosur të hakmarrjes
Asnjë zog shtegtar s'ndalet këtu
Largohen si hijet e dyshimta
Fluturojnë përtej mendimit të krakëllimës

Më patën thënë se bari asnjëherë
Nuk e përjetoi ekstazën e gjelbërimit
Sa herë që arrinte dimri
Te lisat e dasmorëve
Çdo herë vdiste nga një pëllumb në fluturim

VDIQËN EDHE MREKULLIT QË QUHESHIN ËNDËRRA

Ndoshta pas njëqind vjetëve
Për habinë e të gjithëve
Filluam t'i dallojmë ato pak nuanca
Më falni por unë asnjëherë
Nuk isha në gjendje
Ta shijoj bukurinë e lirisë

Nga shpirti im i virgjër
I këputën të gjitha lulet
Që i shihja
Vetëm në ëndrrat e mia të ndaluara
Ishte një kohë e çmendur
Sikur yjet këputeshin mollët e papjekura

Askush s’mund të më kuptoj
Përpos atij personi
Që i kishte të ndaluara ëndrrat
Ngjante që harronim të flisnim shqip
Alfabetin na e çoroditën
Me disa shkronja të shthurura

Vetëm ato pak ëndrra që më kujtohen
Janë nga koha e adoleshencës

Me mjeshtri i pata vendosur
Në arkën e vogël të gjyshes
Por me vdekjen e saj
Vdiqën edhe mrekullitë që quheshin ëndrra

Prishtinë, 3 dhjetor 2016

SA SHUMË KAM NEVOJË

Mbi fushat e vdekura
Fluturojnë zogjtë prej deltine
Asnjë njeri nuk duket
Përpos kryqeve të drurët dhe heshtjes
Asgjë s'dallon syri i zgërlaqur i kohës

Fosile drurësh dhe kuajsh të karbonizuar
Mbase edhe varre pa kryqe
Të vithisur ushtarësh
Në fund të sinorit
Dënes një gur i përlotur
Dënes si era e shthurur e pranverës

Nuk dihet se cilës kohë i përkasin
Këtu çdo gjë është e fosilizuar
Por gjithsesi janë të një moti
Kur në shpirtra njerëzish
Thyheshin shpatat dhe mëzdrakët

S’paska mbetur asnjë shenjë zjarri
Qenkan zhdukur edhe hinoret
Sa shumë kam nevojë
Për një grusht dhe të atdheut tim
Ta varrosi këtë kryq
Në shpirtrat e pathyeshëm të pemëve delikate

ASNJË SHTAMBË NUK MBETI

Thonë se në fushën e mëllenjave ishte
Një luftë e madhe
Asnjë shtambë nuk mbeti
Pa u thyer
Në lotin e vashës kosovare
Kishin pas notuar etjet e përmallimi

Janë parë edhe kuaj të ngordhur
Flutura krah thyer
Ushtar me heshta prej mishi
Kryqe dhe varre
Njerëzit duke i bartur me xhelozi
Gjymtyrët e shpëtuara të ditës

Ishte një luftë e madhe
Sa që fundi i vdekjes
Nuk dukej askund
Nën plepat e prera grumbuj kryqesh
Qanin si kërthinjtë fatin ushtarëve
Qanin lotin e së nesërmes

PËR T'I SHËRUAR DHEMBJET E PLAGËVE PELIN .

Njerëzit s'dukeshin askund
Një rrugë pa fillim
Kurse përfundimin
Ndoshta do e takojmë në një tjetër shekull
Lulet atë kohë kishin mbetur pa frymëmarrje

Ishin një tjetër lloj kalorësish
Pa shalë dhe dizgjin
Kalëronin drejtë vdekjes
Dhe i zuri nata e korbave
Kurrë më s'pushuan krakëllimat

Një pallë magjike farkohej
Në heshtje
Prite kalorësin e padukshëm
Atdheu dukej i vdekur i ngjante kufomës
I ngjante një peme që s'merrte frymë

Ishin kohërat e liga për ne
Shpirtin dhe gjakun na e merrnin peng
Në peng u shndërrua i tërë atdheu
Po të dëgjohej një kollitje mali
Sa ora binin kokat e pengjeve

2.

Dielli lindte në anën e kundërt
Të qiellit
Atje gatuhej trishtimi
Fëmijët na rriteshin me emra të konvertuar

Nëpër shpellat e kujtesës
U deshtë ta varrosim kryqin
Të harrojmë kush jemi

Dhe nga erdhëm në këtë dynja

Perënditë na e kthyen shpinën
Një zjarr i madh
Digjej në një heshtje tinëzare
Digjeshin edhe kryqet nëpër varre

3.

Ngjau ajo që duhej
Të mos ngjante kurrë
Ndryshuan edhe fytyrat e varreve

Nuk dihej më së në cilin drejtim
Ta vendosim kokën
E në cilën anë këmbët

Nëpër qytete vdisnin meshat
Ua kthyem shpinën gjyshërve
Na varrosnin pa kryqe e nishan

Një daulle dëgjohej netëve të vona
Ose mëngjeseve herët
Tellalli i thyente qepenat e mendjes

Fshatrat e ndjenin vdekjen

Kurse qytetet
Kaherë veç kishin vdekur

Mortja e zezë rrinte ulur
Në çdo prag shtëpie
Rrinin në dy gjunjë edhe pemët e prera

4.

Imzot
Nuk e kuptoja ëndrrën e juaj
Paramendoja si një i çmendur
Qejfet e haremeve
Athua vallë e harruat atdheun

Më fal o Imzot
Por unë e kisha nga frika
Dhe më ngufatnin mendimet e liga
Sa që u bënë ankthe
Që ngjanin me trishtimin e jetës

Nuk isha në gjendje
Ta lexoj mendimin e Juaj Imzot
I lutesha Hyjit për vdekjen time
Që shpirti im
Të hynte në shpirtin e juaj

Atdheu jetonte në ethe
Për çdo ditë
Vdisnin nga pak malet
Imzot vdisnin njerëzit
Sa shumë kemi nevojë për pallën magjike

5.

Qëmenatë nëpër rrugicat
E ngushta të Krujës
U dëgjuan rrapëllimat e qepenave
Në secilën dritare
Qëndronin të kyçura llambat

Një dritë inkandeshente
Kalonte në drejtim të kalasë
Për herë të parë njerëzit panë
Se si qeshnin kalldrëmet e lashta Ilire
Buzëqeshnin edhe malet krenare

Imzot Ju jeni tani e tutje
Zot në truallin e Juaj
Shikoni se sa me mburrje
Shikon palla magjike përbuzjen
E hijeve në ikje

Kruja krenare tok me shpendin dykrenor
Sa madhërishëm fluturojnë
Për t'i shëruar
Plagët e pashëruara të atdheut
Për t'i shëruar dhembjet e plagëve pelin

KRAKËLLIMA KORBASH DHE ÇAFKASH

Takoj njerëz me shikime
Të zbrazëta
Shikojnë hapësirën e ngarkuar
Me të gjitha llojet e dhembjeve
Shikoj vijën e kuqe në horizont

Shikoj dhe shoh se si vdesin
Pulëbardhat në fluturim
Kurse uji i kristaltë
Që buron nga qiejt s'mund të shëroj
Asnjë plagë të atdheut

O njerëz dëgjoni grahmën e fundit
Të krenarisë së lisave
Gjethet veç janë dorëzuar
Krakëllima korbash dhe çafkash
S'pushojnë nëpër çatitë e qyteti

Po më ngufat ky boshllëk
Me cilin melhem ta lyejmë dhembjen
Si të ja shërojmë plagët e lisit
Ky plis i bardhë po njolloset
Me gjakun e juaj të prishur

MJAULLININ EDHE GURTË

Këtij trualli për çdo ditë
Po i hapen plagët
Dhe varret
Si t'i shpëtojmë degët e lisave
Që po thyhen nga pesha e ligësisë

Mbrëmë një kohë të gjatë
I dëgjuam mjaullimat e egra të maceve
Mjaullinin edhe gurtë
Një mal me dhembje
Rrokullisej nëpër shpirtin e plagosur

Nuk mundem më të marr frymë
Po më ngushtohen damarët e gjakut
Largojeni atë kryq
Nga varri i vithisur i atdheut
Lisat këtu kurrë nuk vdesin të gjunjëzuar

Dua që sonte të shikoj përpara
Asnjëherë mos ta kthej kokën mbrapa
Dua të eci pandërprerë
Deri në fund të rrugës së gjakosur
Atje ku më presin përmendoret e mermerta

MË NDJE GURI I LAGJES SIME

Vonë kuptova
Se më është lodhur zëri
Me cilën gjuhë t'i drejtohem atdheut
Këtu gurtë dhe drurët
Si qilimi po qajnë

Çfarë të bëj me këmishën tënde
Çfarë të bëj me dhembjen tënde
O atdheu im i grisur
Çfarë të bëj
Me plagët që s'kanë shërim

Mbrëmë mu fundosën në gjolin e pafund
Të gjitha shpresat
Mbeta lakuriq si shkëmbi i thyer
Asnjë shpend nuk pati forcë të ulet
Në dhembjen tënde të madhe

Më ndje guri i lagjes sime

Më ndje deri në gjunjëzim
Për këtë dobësi lotësh
Por edhe burrat dinë të qajnë burrërisht
Bile të dënesin si gurtë e murrmë të atdheut

Prishtinë, 4 nëntor 2016

KOLLITEN EDHE DRURËT

I pyes manat e egra
Nga rrënjët tringëllijnë gjethet
Sonte nuk më duhet asnjë përgjigje
Më mjaftojnë heshtjet e gurëve

Një stuhi e përlotur
Zbret nga përroi i djallit
Zbret me të gjitha të ligat e dynjasë
Kurse shiu rebel troket në ndërgjegje

Mjaft më hesht njëherë
Kjo lehje e pakontrolluar nate
Po ua prish gjumin e yjeve

Që me vite nuk fjetën rehat

Nuk di përse por shumë keq
Po më ngacmon kolla
Kolliten edhe drurët
Ky trishtim i çmendur po i trand lisat

NGA SYTË E PËRGJUMUR TË VASHAVE

Një grua ose një njeri
Në këtë kohë asnjanëse
Fare nuk luan rol gjinia
Pasioni i egër
Shndërrohet në furtunë

Nga degët e shkundura të gështenjave
Bien pikat e vonuara të shiut
Kurse në katin e shtatë
Vaçe zela
Bisedon me telat e këputura të kitarës

Kësaj i them unë stina e ullinjve
Ku farat piqen
Dy javë para kokrrave
Piqen si sytë e vashës adoleshente
Kur takohen me rrezet e para të diellit

Disa gra po ashtu edhe disa njerëz
Të panjohur zbresin monopatit
Me ca degë të këputura ullinjsh
Nga sytë e përgjumur të vashave
Lindin fluturat e para të agimit

PULËBARDHA

Asnjë njeri s'kishte mbetur te fanari
Taverna e vetmuar
I numëronte në heshtje
Përmbytjet e varkave të peshkatarëve

Një heshtje mortore
Si kryqi qëndronte e ngulur mbi varr
Nëpër skutat e molit

Pulëbardhat i kishin harruar fluturimet

Vetëm një patë e egër
Qëndronte ulur mbi kiçin kujtesës
Qëndronte duke shikuar me nostalgji
Jonin dhe krenarinë e detarëve jonian

NUK MEJNË AS ZJARRET

Një turbullirë e zezë
Po u ngjan anijeve të vdekura
Nëpër hapësirën e errët të qiellit
Kryqet e ngulura duken si varret
Nga palca e një meteori
Furishëm shpërthejnë uturimat e mjegullave

Pemët janë stivuar nëpër stoqe
S'bëzajnë as rrënjët
Yjet e ngrira
I pështynë dhëmballët
Nëpër qiellin e atdheut tim
I shohim kalorësit e hekurt të Apokalipsit

Nuk mejnë as zjarret
Gjëmat e gjelbërimit ndihen thellë
Në shpirtrat e drurëve
Kosat e vdekjeve i mprehin dhëmbët
Sivjet ky dimër
Do i ndjen thellë piskamat e fosileve

NGA TRUNGU I TIJ STOIK

O jo Zoti nuk ishte askund
Përpos plumbave
Asgjë nuk dukej në hapësirë
Pas ikjes së perëndive
Këtu paskan vdekur shpresat e mbijetesës

Pikë loti nuk pashë
Në syrin e zgërlaqur të rrapit
Ishte gjysmë i vdekur
Por krenar si perënditë
Një hap s'bëri më tutje

Sa shumë i ngjante tokës
Së atdheut tim
Ndoshta që nesër
Nga trungu i tij stoik
Zotat dardanë do ja gdhendin djepin

PAPRITMAS U HAPËN PORTAT E QIELLIT

U dëgjuan të lehurat e lukunive
Ushtarët narkoman
Shqelmuan nëpër dyer si kuajt e paçjerrë
Më pastaj hapat e shurdhëta
Shkelën mbin kalldrëmet ilire

Heshtën britmat
Dhe piskamat e pandërprera të nënave
Në majat e hanxharëve pa zë
Qëndronin kërthinjtë
Ata donin ta vrisnin jetën dhe e vranë

Asnjë lule molle
Nuk mbeti nëpër kopshtet e qytetit
U thanë edhe stinët
Era e barotit mbolli vdekjen
Mbolli gjymtimin e foshnjave

Papritmas u hapën portat e qiellit
Fluturuan hapësirave
Të shpresës dykrenorët e çeliktë
Bubuzhelet dhe minjtë e kanalizimeve
Shpëtimin e kërkuan nëpër gjirizet ilire
SECILI PREJ NESH LE TA LEDHATON KONDAKUN

Nuk është koha e pritjes
Të gjithë duhet të jemi në rrugë
Nëse duhet të jetojmë
Domosdo duhet të vrasim

Shikoni ushtarin e huaj
Se si kërthndezet
Mbi atë pleh që kundërmon
Si një fosil nga mesjeta

Duhet larguar plehun nga udha
Po se bëmë këtë
Do na e zë frymën
Për të jetuar s'duhet zgjedhur mjete

Shikonim kazermën përballë varreve
Se me çfarë gjuhe
Bisedonte me të vdekurit
Për të jetuar duhet kafshuar armikun

S’është koha e ledhatimeve
Secili prej nesh le ta ledhaton kondakun
Atdheu është ngritur në këmbë
T’i japim armikut çfarë meriton
Prishtinë, 5 dhjetor 2016

SI RRËSHIRA E ZEZË I ÇURGON URREJTJA

Çfarë do që të flas e shkruaj
Mund ta quaj kotësi
Çfarë kuptimi ka fjala dashuri
Kur urrejtja ja merr anën

Njeriu sot nuk matet me asgjë
Është më i rëndë se plumbi
E më i lehtë se ajri i ndotur
Ky pra është homo sapiensi

Parakalon rrugëve me të gjitha të ligat
Dhe të mirat
Që i ngarkohen në shpirt

Është gjysmë filantrop e gjysmë mizantrop

Në pasqyre fshihet nga vetvetja
Mjeshtërisht tregohet dikush tjetër
Kurse nga fijet e thinjave të flokëve
Si rrëshira e zezë i çurgon urrejtja

ZOT KRENAR I ZOTAVE TË OLIMPIT

Një dru as i njomë
E as i tharë
Me mija gjethe si milingonat
Mbulohet me flamujt e grisur

Nga të katër anët
Ballafaqohet me tufanet e zi
Edhe kur është në dy gjunjë
Nuk e pranon vdekjen

Atdheu im djep i gdhendur
Nga shpirti i rrufeve
Asnjëherë nuk vdiq
Por edhe askurrë nuk u dorëzua

I përjetoj shtatë katarzat
Shtatë herë e gozhduan si Krishtin
Por kurrë dhe asnjëherë

Nuk ja pamë lotin në sy

Ky është atdheu im
Nocioni i pathyeshëm i shpirtit
Perëndi për të gjitha fronet e dynjasë
Zot krenar i zotave të Olimpit

2.

Herë më duket si një zog i verbër
E herë i ngjanë dykrenorit
Syri vër nuk i bën
Kur mbi shpirtin e ti derdhen
Të gjitha tufanet e dynjasë

Një gjysh njëherë më tha
Se këto male kanë lindur nga vdekja
Dhe asnjë vdekjeje më
Nuk i frikohen
Kur është nevoja u dalin në bejleg perëndive

Atdheu im i Gjergjit
Dhe i Gjergj Elez Alisë
Ku nga secili rrap buron fjala
E Lekës dhe zëri i njohur i thirrjes
Atdheu i gjyshërve dhe perëndive krenarë

3.

Sa herë që pate nevojë
Pa e çel gojën
Djemuria e prite urdhrin tënd
Atdheu im i sfilitur
Prite zërin kumbues të Gjergjit

I doli përball katallanëve
Nuk njohu perëndi
Luftoi edhe kundër djallit
Nëntë herë i shkeli malet e robëruara
Për të ja zënë pritën armikut

Atdheu im
Flamuri im i vetëm
Mbi trupin tënd u shtrin fosile kuajsh
Dhe njerëzish
Por gjithsesi ishin krenarë si ti

Andaj të dua
Të dua se ti asnjëherë nuk e pranove vdekjen
Kur thanë se vdiqe
Ti mu atë çast u ngrite në këmbë
Dhe si feniksi krenar fluturove hapësirave

4.

Kur nuk patëm asnjë shans tjetër
Nga malet e atdheut
Sajuam një flutur
Një flamur dhe një shpend dykrenor
Më pastaj fluturuam qiejve

Nuk na u deshtë asnjë avion prej letre
Ishte aq i bukur fluturimi
Sa që kurrë më nuk deshëm
Të zbresim në tokë
Fluturuam deri te yjet që kurrë si njohëm

Dhe për çudi
Atje i pamë varret e stërgjyshërve
Sa shumë ngjanin me tumat e lashta ilire
Ngjanin sa që na lindi një dëshirë
Të varrosemi pranë tyre

Nuk kishim asnjë material
Ose basma për një flamur
Por prej krahëve të fluturave
Sajuam flamurin dykrenor
Dhe e ngulëm në shpirtin e paçmuar të qiellit

5.

Isha tepër i uritur
Lëkura ime i ngjante defit
Kishte një ngjyrë
Të kundërt me atë të mishit
Por gjithsesi ishte lëkurë njeriu

Ju thashë se isha tepër i uritur
Me javë të tëra
S'kisha ngrënë asnjë thele buke
Por më besoni
Atdheun kurrë nuk e tradhtova

Nëpër drunj dhe pemë të shkulur

Vizatoja bukën
Duke e kafshuar lëvoren e drurit
Më dukej se harroja që jam i uritur
Por atdheun kurrë nuk e tradhtova

Prishtinë, 6 dhjetor 2016

Cikli i tretë

Ju thashë se vdekja nuk ekziston

NUK PUSHOJNË AS SERENATAT KORÇARE

Në një çafkë të kristaltë
Vera e zezë
Luante valsin e fundit
Pemët e shkundura
Dënesnin si kërthinjtë nëpër faltore

Edhe një vjeshtë më pak
Në qytetin e kalldrëmtë
Sivjet nuset erdhën pak si vonë
Por gjithsesi
Sazet shtatë ditë e shtatë net s'pushuan

Kishte mbetur edhe pak kohë
Deri te pragu ku rrinte ulur
Vjeshta me tërë begatinë e saj
As barinjtë nuk erdhën
Ende është herët për mjeljen e deleve

Nga tavernat e qytetit
Rrugicave të ngushta
Zbret një muzikë tejet arkaike
Nuk pushojnë as serenatat korçare
Trëndafilat paskan çelur dashuri

SI DRURI LAKURIQ

Ishte dimër mbase edhe pranverë
E hershme
Si druri lakuriq
Qëndroja i dehur në tavernë
Një muzikë e lashtë
I numëronte notat e pikëllimit

Asnjë njeri pranë meje
Tavolinat vallëzonin vallen e vdekjes
Ikonat e vjetruara
Më vështirësi i bënin ballë kohës
Nga banaku dëgjohej si çdoherë
Një muzikë e shthurur

Të dalë në rrugë
Nuk më lejojnë stërkalat e shiut
Frynte edhe një stuhi e marrë
Frynte duke i shkulur drurët e dehur
Një hënë lozonjare
Mes mjegullave dukej edhe më nudo

NUK PASHË ASNJË GOTË TË ZHDEHUR

Vite me radhë nuk shihej qielli
Në qytetin tim
Çafkat e dehura tapë
Filluan të harrojnë
Nocionin e fluturimit

Një zë i shthurur vinte nga lagjja
E evgjitëve
Rropullitë e dehura këndonin
Një këngë të lashtë rome
S'pushonin as sazet në katin e nëntë

Ishte një stinë e mbrapshtë
Pemët atë vjet
Nuk i shkundën frytet as gjethet
Dimri s'merakosej për zahiretë
Sivjet më pak do dëgjojmë palljet e lopëve

Në një pijetore të vockël
Nuk pash asnjë gotë të zhdehur
Ishin dehur edhe dritaret
Dyshemeja me tërë dhembjen e saj
I duronte shkelmimet e valleve të harruara

NGREHIN DOLLI PËR SHËNDETIN E ATDHEUT

Mu nga ky gur i murrmë
Dy zogj fluturuan
Në jetë
Tani ndoshta me përmallim
Ëndërrojnë vendlindjen

Dielli i qiellit të perëndimit
Nuk e ka ngrohtësinë
E ullinjve të pjekur
Këtu çelin lulet e para në vjeshtë
Që të piqen kokrrat në dimër

Dy zogj të bardhë
Që ua marrin anën të gjitha bardhësive
Diku nëpër metropolet e botës
Për çdo Vit ti Ri
Ngrehin dolli për shëndetin e atdheut

Këtu gjithmonë bënë dimër
Piqen dhe shkunden ullinjtë gjithmonë
Në të njëjtën kohë
Kurse Lumëbardhi i numëron guralecët
Duke i shumëzuar me ardhmërinë

UA NDËRROJ VENDET GURËVE TË BARDHË

Në pijetoren e fshatit tim
Gjithmonë ulem
Pranë dritares që e shikon lumin
Shikoj edhe unë
Lojën e përsosur të guralecëve

Dhe si mjeshtër shahu
Ua ndërroj vendet e gurëve të bardhë
Me ato të kuqe
Të parët ngjajnë me fatin
Kurse të dytët me diellin e harruar

Ndonjëherë kur më ngacmon nostalgjia
Ulem në bregun e kundër të kujtesës
Dhe si i çmendur
I laj çorapet e plepave
I laj edhe ato të kujtimeve të hidhura

Kur më zë mbrëmja
Ngrehi dolli me vetveten
Dhe ëndërroj ngjyrën delikate të ujit
I ëndërroj rrugët e gjata të atdheut
Dhe puthjen e zjarrtë me Jonin e kaltër

NDONJËHERË MJAFTOJNË

Nga diku larg si në ethe ndjej
Ardhjen e kalorësve
I shoh dhe kuptoj fare mirë
Etjen e dizgjinëve

Një kalë i bardhë thua se
Zbret nga mjegullat
Në shpirtin tim të dërmuar
I ndjej hingëllimat e kohës

I ndjej edhe zërat e potkonjve
Më duket se ngjajnë me ato të Apokalipsit
Kosa e vdekjes po e ngreh kokën

Ajo e zjarrit zhurit gjelbërimin

Ndonjëherë mjaftojnë
Vetëm dy kalorës të çmendur
I treti dhe i katërti më mirë të mos zgjohen
Të flenë përgjithmonë si vdekja e zezë

KRIDHU EDHE DERI TE QIEJT

Unë jo se jo
Por ti miku im i ri
Ndoshta je në gjendje
Ta harmonizosh shpirtin tënd
Me gurgullimën e ujit

Lumenjtë janë të paparashikueshëm
Në këtë qytet
Herë flenë në mëngjes
E herë në mbrëmje
Zgjohen me tërë forcën e zërit

Ti miku im dëgjo me vëmendje
Oshtimën e përroit
Nga thonjtë dhe qerpikët e tij
Burojnë të gjitha detet
Andaj ty të duhet t'i përngjash burimit

Dhe mos pusho së hulumtuari
Nëse duhet
Kridhu edhe deri te qiejt
Atje do e kuptosh domethënien
E nocionit të etjes për jetë

SHIKONI SE SI RRËQETHEN MALET

Ju lutem gëzohuni në këto çastet
Kur kthehen kalorësit
Hapni porta
Largoni drynat e dylltë
Asnjëri prej jush mos i mbyllni dritaret

Sonte vijnë këtu betejat
E të gjitha kohërave
Flamujt e grisur
Ndërrohen me ata të rinj
Duhet t'i respektojmë hingëllimat e kuajve

Kjo natë është mbase e shenjtë
E cila përsëritet çdo njëqind vjet
T'i presim pra kalorësit
Ashti siç i ka hije fisit tonë
T'i presim triumfatorët të gjitha betejave

Ja shikoni se si një Diell i Ri

Kalëron mes tyre
Sa shumë i ngjan Gjergjit tonë
Shikoni se si rrëqethen malet
Nga dashuria rrëqethen edhe gurtë

Prishtinë, 7 dhjetor 2016

JU THASHË SE VDEKJA NUK EKZISTON

Varianti i dytë

Kur vijnë të reshurat
Si patat e egra gjelbërimi ngre kokën
Unë ju kam thënë me një rast
Se vdekjes nuk i besoj
Nuk i besoj sepse ajo nuk ekziston

Gota ime e mbushur me verë
Sa herë që zbrazet
Sërish mbushet nga një dorë e padukshme
Po ashtu as zbrazjes nuk i besoj
Ekziston gjithmonë dikush që e mbush

Jeta e njeriut ngjan me lumin
Në çastin kur shteren brigjet
Si nga ndonjë legjendë ringjallen dallgët
Dhe lumi mbushet me gjelbërim
I cili vdekjen kurrë nuk e pranon

Ju thashë se vdekja nuk ekziston
Po të ekzistonte
Sa ora do vdiste kjo botë e bukur
Shikoni kokrrat e ullinjve
Çdo stinë përsëriten si askurrë më parë

ISHA I DEHUR TAPË ME TRISHTIMIN

Asnjëherë nuk pata fat
Ose nuk më shkoi për dore
Ta pikturoj dashurinë
Ngjyrën e saj blu
Në sytë e kaltër të qiellit

Sa herë që desha të skicoj
I ngjante gotës së mbushur me pelin
Përreth meje ndjeja
Se si vallëzonin tavolinat e gurtë
Kurse gota si me magji mbushej pikëllim

Unë nuk mësove kurrë t'i dalloj ngjyrat
Mbase kisha një lloj verbësie
As dashurinë nuk e pashë
Kur kaloi lakuriqe pranë meje
I ngjaja drurit të trishtimit

Askush nuk më kuptoi
As unë askënd nuk e kuptove
Kështu që hijet e verdha kaluan pran ë meje
Kaluan pa e prekur bukurinë e heshtjes
Në sytë e zgërlaqura të ditës dëneste kujtesa

BUBUZHELET SONTE MARRËZISHT VALLËZOJNË

Me kë po flas sonte
Kjo gotë e kristaltë si një zog i trembur
Dridhet në duart e mia
Dridhen edhe këmbët e tavolinës
Kamerierja syjeshile shikon në zbrazëtirë

Nga banaku i vjetër
Më vijnë zërat e së kaluarës
Derdhen si lumenjtë e çmendur
Nëpër kujtesën time
E cila më s'mund të quhet kujtesë

Pyes veten se kush jam në këto çaste
Me kë bisedoj sonte
Kur asnjë yll nuk duket hapësirës
Në gjeografinë e shpirtit tim
Paskan vdekur të gjitha yjet e adoleshencës

Një heshtja lakuriqe parakalon
Nëpër dyshemenë e ronitur
Bubuzhelet sonte marrëzisht vallëzojnë
Një valle të vjetër pagane
Në çastin kur ishte duke vdekur nostalgjia

I KUJT VALLË MUND TË JETË

Ndoshta edhe një gotë
Dhe fundi më pret të plepat
Do pimë sonte miku im
Do pimë aq shumë
Derisa të zhdehen kujtimet

Më prek pak ta ndjej pickimin
E kësaj nate
Të ndjehem si dikur
Ta ngrehim dollinë e një kohe
Kur ishim mes të gjallëve

Të thashë më prek
Sonte është koha kur duhet t'i zgjojmë
Gotat e përgjumura të rinisë
Të zgjohemi edhe ne nga kjo vdekje
Se për ndryshe na presin te plepat

Shikoje atë yll që bie ngadalë në tokë
I kujt vallë mund të jetë
Që po i përngjan galopit të erës
Po hingëllon si kali i egër
Kur ja lëshojmë dizgjinët e kujtimeve
DËGJOJE REFRENIN E LIRISË

Sonte është koha
Të ngrehim dollinë për ty atdhe
Për flamurin e grisur të lirisë
Heronjtë që të nderuan
Në kohërat më të vështira të historisë

Mbushni të gjitha gotat me dashuri
Ta ngrehim dollinë
Të cilën akoma nuk e ka ngrehur askush
Atdheu im
Ti meriton aq shumë
Sa që dua të dehem me dhembjen tënde

Kjo muzikë që kaq madhështore
Zbret nga yjet
Është vetëm për ty
O atdheu i im
Dëgjoje refrenin e lirisë
Sa madhërishëm këndojnë zanat e Alpeve

Mbushni pra ju lutem
Mbushni gotat
Sonte dua të dehemi
Dhe të këndojmë të gjithë në kor
Himnin të cilin e këndojnë vetëm perënditë
Për ata që burrërisht u flijuan për atdhe

RRI SA MË LARG SE PËRNDRYSHE MË HARRON

Ma lësho dorën
Rri pesë hapa larg meje
Ti nuk kupton se sa me pëlqen kështu
Vetëm në errësirë
Flokët e mia të thinjura
Ngjajnë me nocionin e dritës

Të thashë ma lësho dorën
Mos m'i prek rrudhat e dhembjeve
Me lejo të të përqafoj
Nga kjo largësi e padukshme
Kështu që nesër do të të kujtohem
Si statujat e lashta antike

O të lutem ma lësho dorën
Shumë herët u mësova të eci në jetë
Qëndro sa më larg meje
Kështu që kurrë nuk do ta kuptosh
Shijen e erës së lëkurës sime
Rri sa më larg se përndryshe më harron

I PËRQAFOJMË TRËNDAFILAT

Ndoshta një ditë e një kohë
Do na dalin krahët
Do u ngjajmë zogjve pretarë
Ose atyre që jetojnë në kuvli
Por gjithsesi do jemi zogj
Që në fluturimin e parë nuk dështojmë

Stinët në qytetin tonë
Gjithmonë ndryshojnë
Rrallë herë dihet kur është dimri
E kur piqet vjeshta
Me të gjitha frutat e saja
Pranvera dhe vera as që duken në horizont

Ne i shtrijmë duart hapësirave
I përqafojmë mjegullat e hirta
Bile edhe ato shtatzëna
Që janë të ngarkuara me breshër e shira
Ende pa u dehur gjembat në rrënjë
I përqafojmë trëndafilat

MU DESHËN NDOSHTA NJËQIND VJET

Më besoni ndoshta ajo ishte
Diku këtu
Shumë afër nesh
Ose atje te yjet
Atë ditë kur zbriti në tokë
Hëna e fshihte fytyrën e saj lozonjare

Atë çast u verbova
Ngjaja lahutarëve të vjetër
Por për dallim prej tyre
Kurrë asnjë këngë
Nuk isha në gjendje të këndoj
Vetëm dëgjoja sirenën e ujit

Mu deshën ndoshta njëqind vjet
Të mësoj si duhet
Alfabetin e dashurisë
Dhe e mësova
Që në flokët e saja të mëndafshta
Të luaj në harpë lojën e lashtë të perëndive

PLEPI NË QYTETIN TIM

Sa shumë kjo dritë dallohet nga errësira
Mund të jetë edhe anasjelltas
Plepi në qytetin tim
Është njëqind vjet më i lartë se bari
Por edhe njëqind herë
Vuan më shumë nga epilepsia

Nuk i frikohet tufanit e as stuhisë
Edhe kur fishket
Tregon një forcë titanike
Përpos milingonave të kuqe
U kundërvihet të gjithëve
Në jetën e tij rebel

Ky lloj bari i atdheut tim
Me mija vjet e ka mësuar

Artin e qëndresës
Sa herë që i ka përjetuar putrat
E ariut polar
Po aq herë ka ngadhënjyer mbi vdekjen

Prishtinë, 8 dhjetor 2016

MES KËSAJ SHUMËSIE GJYSMASH

Sonte qenkan përgjysmuar gjërat
Një gjysmë qeshje
Pashë në sqepin e dallëndyshes
Kurse kjo gjysma tjetër e gotës
Më duket se i ngjan një gjysmë lëmoshe

Në pijetore kishte mbetur
Vetëm një gjysmë karrige
Cili gjysmë njeri
Sonte do të ulet pranë meje
Me ndonjë gjysmë gote të thyer

Edhe nata qenka përgjysmuar
Nga mëngët e saja të prera që duken
Si vela të dehura të anijeve gjysmake
Derdhen gjysmë shirat
Me stërkalat e këputura në disa gjysma

Mes kësaj shumësie gjysmash
Sa do doja të dëgjoj
Një gjysmë fjale nga ndonjë gjysmë njeri
Të mos shndërrohem në një copë
Gjysmë gur e gjysmë dhembje

NËSE VEPROJMË NDRYSHE

Ndoshta duhet që një ditë
Ndoshta edhe tani
Ta përditësojmë fotografinë tonë
Nuk duhet të ngjajmë me ikonën
Në kornizën e vjetër të kujtesës

Kjo fotografi përballë pasqyrës
Duket si një karikaturë qesharake
E shekullit të kaluar
Tani kemi ngjyra më alegro
Mund ta ngjyrosim qiellin kur mërrolen yjet

Të kujtohet që asnjëherë nuk u dorëzuam
Stihisë së shthurur
Secilën herë matëm shtatë herë
E premë vetëm njëherë këmishën e erës
E premë edhe pemën që s'çelte më lule

Eja pra ta largojmë ikonën e vjetër

Në vend të saj ta vendosim
Yllin Polar
Nëse veprojmë ndryshe
Nuk di se si do të orientohemi në jetë

Prishtinë, 9 dhjetor 2016

ALEPO NË HARTËN E TURPËRUAR TË BOTËS

U doli flaka gërmadhave të fundit
Asnjë fëmijë më
Nuk ka se si të vrapoj pas fluturave
Përpara syve të dynjasë
Në kërthizën e Alepos
OKB-ja rra në provimin njerëzor

Rra i tërë njerëzimi
Si i prerë në kokë u gjunjëzua
Vetëm fluturat e vdekura
I kërkojnë krahët mes muranave
Mbase u dashuruan me zjarrin
Shijuan shijen e trishtuar të vdekjes

Njeriu bishë e egër për njeriun
Si ujkonja kafshonte
Qengjin e pjekur në zjarr
Piqeshin edhe ëndërrt e zogjve
Në hartën e turpëruar të botës
Piqej një qiell i kaltër i lirisë

Kur i tërë qyteti u shndërrua në zjarr
Erdhën zjarrfikësit
T'i shkyçin shpirtrat e djegur

Një foshnje në barkun e nënës
Me ngashërim u lutej
Dhe njëkohësisht i mallkonte yjet

Prishtinë, 16 dhjetor 2016

SHËNIME PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind më 1 shkurt 1943 në Prizren. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Disa kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e Qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret, kryesisht me poezi, që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë, të cilën e botoi në revistën "Pionieri" më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës, bashkë me shokët e punës dhe të pendës, themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në kuadër të punës së këtij grupi letrar, qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës, që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Muresha. Është prezantuar në Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,

nga Hasan Hasani, në Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 – 1995, nga Odhise K. Grillo, si dhe në librin Portrete Shkrimtarësh nga Demir Behluli, Prishtinë, 2002. Në maj të vitit 2013 Klubi i Artistëve dhe i shkrimtarëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin e dhënë në letrat shqipe.
Jeton dhe krijon në Prishtinë.

BOTIME TË AUTORIT

1.“Puthje”, poezi, “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “Ecjet e viteve të mëdha”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. “Çamarrokët e Thepores”, poezi për fëmijë, “Shkëndija”, Prishtinë 1996.
4.“Muret”, poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997
5. “Morfologjia e dhembjes”, poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2000
6. “Ai vjen nesër”, poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2007
7. “Letër nga mërgimi”, poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu” Kastriot, 2007
8. “Letër nga mërgimi 2 “ poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. “Udhëndarja”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o“Thirrje e gjakut”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. “Asgjë sikur molla”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.

12. “Vesa në lotin tim”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “Puthja e gozhduar”, poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2009.
14. “Kashelasha në vargje”, poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2009.

15. “Pema e bekuar”, E përkthyer, Rumani, 2010.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. “Hijet e ndryshkura”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
18.”Stuhi në Kutulishte”, poezi, ”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
19. “Posa ikte nata”, poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot, 2010.
20. “Loja e myshqeve”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010.
21. ”Lumëbardhi dhe gjëma”, poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
22. “Metafora e heshtjes”, poezi, “Qendra e kulturës”, Kastriot, 2010
23. ”Hyji në Prekaz”, poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot, 2010.
24. ”Sinorët e hinores”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot 2010.
25. ”Don Kishoti dhe Rosinanti”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26.”Zjarri i dashurisë”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
27. ”Kur likenet vallëzojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010

28. “Ditari në vargje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
29. “Tingujt që nuk përfundojnë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010.
3o.“Shtegu i mallit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
31. ”Korniza e thyer”’, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2010
32. “Zgjimi i gjëmës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtareve, Kastriot, 2010
33.“Vallja mistike”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
34. ”Merre kodin”, Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
35.“Letër atdheut” poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
36. “Tejdukshmëria e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
37. “ Përtej teje”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
38. “Sa afër e sa larg”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2011
39. “Vallja e zanoreve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
40. “Ikja e eshtrave”, Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2011
41.”Kalorësit e mjegullave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
42. “Hingëllimat e shiut”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
43. “Kur pemët i ndërrojnë këmishët”. Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

44. “Mirëmëngjes Imzot”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
45. “Kafshimi i mikut”, Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
46. “Atje tej maleve”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot, 2012
47. “Heshtja që del në shesh,” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
48. “Portat e shpresës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
49. “Në dhomën time gjysmë të errët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
5o. “Kinse Lojë Shahu”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
51. “ Për çdo dekadë nga një baladë “, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
52. “Fusha e mëllenjave”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
53. “E kujt është kjo vetmi”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
54. “Mos pyet për adresën e lumit”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
55. “ Stoli në parkun vjetër” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
56. “Urori i stralltë”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
57. “Po të mos ishte fjala”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot,2012
58. “Thyerja e urave”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
59. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

60. “ Në flokët e dëborës”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
61. “Një grusht nostalgji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
62. “ Kur filluan të flasin njerëzit”, poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
63. “Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
64. “ Lisi në rrënjët e veta” , Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
65. “Eca ecëm dhe do ecim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
66. “Fëmijët e erës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot 2012
67. “ Çast në fund të stinës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
68. “Si të flas me drurët”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
69, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
70. ”Andej dhe këndej kohës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
71. “Zëri i heshtjes”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
72. “Kush i lexoi letrat prej erës”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012
73. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”, prozë poetike, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
74. “Koha e ime dhe koha e jote”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot , 2012
75.” Diku te një baladë”, Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

76. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2012

78.“Pyesni zogjtë në ikje ”,Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot 2013
79 “ Përfërimë gjethesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
80. “Refrene yjesh”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
81. “Te delta e mjellmave”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
82.“Rinjohja”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
83.“Diku në fund të një fillimi”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
84.“Mëkati i hijes”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013
85.“Një zog prej uji”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2013

86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
89.”Kur dehen perënditë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014.

91.”Krakëllimat e natës”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
93. “Atdheu i paçmuar”Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “ Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
94.”Psalm i harruar ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”Kastriot 2014
95,”Për kë po bie moj kambanë”, Poezi Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
96. “Mbi flokët e ullukëve”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
97. “Menatë vijnë lejlekë”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
98. “Loti i gotës së dehur” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
99. “Stina asnjanëse”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
100. “Dëneste bashkë me erën” Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu” Kastriot 2014
101. “Druri i pikëlluar”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
102. “Një grusht dashuri”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
103. “Lëreni zërin tim”, poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
104. “Shi në qytetin tim”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
105. “Si trenat e verbër ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
106. “Zjarri i malli tim ”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014

107. “Kur teshtin era”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
108. “Mbi shpirtin e erës pagane”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
109. “Nëpër gjymtyrët e mjegullave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2014
110”Ajo nuk erdhi sonte” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
111.“Një hënë e zhveshur”,Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
112. “Nëpër plasaritjet e mureve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
113.“Mes telave gjembor ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” ,Prishtinë, 2015
114. “Të vizatosh një zog në mur”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
115.” Nuk flenë as kuajt e dehur” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
116.”Fluturojnë zogjtë e verbër ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
117. “Një shi prej bryme” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
118. “Në prehrin e pemëve” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND” , Prishtinë, 2015
119. “Zëri i largët i shiut ”, Poezi Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
120. “Yjet e ngrira të kujtesës ” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
121. “ Thirrmat e hijeve”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015

122. “Dritaret e verbëta ”, Poezi, Shtëpia Botuese”TREND”, Prishtinë, 2015
123 . “Përtej portave të mbyllura” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2015
124. “Malli i etjes” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
125. “Kur qajnë pemët ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
126. “Të dielave në qytetin tim ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
127. “ Nëpër brigjet e kujtesës” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
128. “Rrugës qante një stërqok”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
129. “Kali im prej bore” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
130. “Përballë hijes së mollës ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
131. “Jehu i zërave”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
132. “Në kujtesën e pemëve ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
133.“Më mirë një gjysmë ëndrre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND “, Prishtinë, 2016
134.“Një dry prej dylli ” Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016.
135.“ Në anën tjetër të mendjes”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
136.“Sa shumë ethe pat dimri sivjet”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
137. “Enigmat e kashelashave ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016

138. “Nuk i them uinë dot kësaj liri” , Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
139. “Fluturat prej letre ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
14O. “Fluturimi i gjinkallës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2016
141.“Kumritë prej deltine”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2016
142.“Më pritni te baladat e gurit”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017.
143.“Trenat këtu gjithmonë vonohen”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
144.“Lulëzojnë gjethet e ullinjve”, poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë, 2017
145.“Teatri antik i kujtesës”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
146.“Portreti i lirisë”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
147.“Një stinë delikate”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
148.“Te ullishtat e vjetra ”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
149.“Ishim të lumtur si gjinkallat”, poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017
150.“Pikëllimet e rrënjëve”, Poezi, Shtëpia Botuese “TREND”, Prishtinë. 2017
151.“Telat e shirave ” poezi, Shtëpia Botuese TREND”, Prishtinë, 2017

PËRMBAJTJA:

Cikli i parë
Telat e shirave 13

Vendosi dy fleta të mykura gjethi 15
Telat e shirave 16
Heshtë moj kukuvajkë 17
Një zë buron nga nëntoka 18
Shkelim mëkatin e lindur 19
Ora e vjetër 20
Nuk di se cila kohë ishte 21
Deti i çmendur lindte një tjetër det 22
Sa herë që mbufaten lumenjtë 23
Në agullimë t'i zgjojmë të vdekurit 24
Të zi e pate diellin e qiellin 25
Këndojnë edhe çafkat e bardha 26
Sërish i kreh flokët e thinjura 27
Pemët delikate 28
Ky shurdhim i ajrit 29
Kur na zë gjumi ai i vdekjes 30
Mos thuaj asnjëherë jo 31
Askush asnjëherë nuk kuptoi 32
Ne ende jetojmë në sterrë 33
Arratisen të gjitha gëzimet 34
Rri varur portreti i shthurur i erës 35
Ndoshta më harron ky gur i zi 36

Tani është dimër 37
Si të dalë nga kjo amulli 38
Zbrit e të humbtë fara e fisi 39

Cikli i dytë
Vdiqën edhe mrekullitë që quheshin ëndrra 41

Ku secili pikturon ëndrrën e vet 43
Thonë se kurrë nuk e ndali fluturimin 44
Nëse ne mungojmë 45
Kurse dielli i copëtuar 46
Vdiqën edhe mrekullitë që quheshin ëndrra 47
Sa shumë kam nevojë 49
Asnjë shtambë nuk mbeti 50
Për t'i shëruar dhembjet e plagëve pelin 51
Krakëllima korbash dhe çafkash 56
Mjaullinin edhe gurtë 57
Më ndje guri i lagjes sime 58
Kolliten edhe drurët 59
Nga sytë e përgjumura të vashave 60
Pulëbardha 61
Nuk mejnë as zjarret 62
Nga trungu i tij stoik 63
Papritmas u hapën portat e qiellit 64
Secili prej nesh le ta ledhaton kondakun 65
Ai rrëshira e zezë i çurgon urrejtja 66
Zot krenar i Zotave të Olimpit 67

Cikli i tretë
Ju thashë se vdekja nuk ekziston 73

Nuk pushojnë as serenatat korçare 75
Si druri lakuriq 76
Nuk pashë asnjë gotë të zhdehur 77
Ngrehin dolli për shëndetin e atdheut 78
Ua ndërroj vendet e gurëve të bardhë 79
Ndonjëherë mjaftojnë 80
Kridhu edhe deri te qiejt 81
Shikoni se si rrëqethen malet 82
Ju thashë se vdekja nuk ekziston 83
Isha i dehur tapë me trishtimin 84
Bubuzhelet sonte marrëzisht vallëzojnë 85
I kujt vallë mund të jetë 86
Dëgjoj refrenin e lirisë 87
Rri sa më larg se përndryshe më harron 88
Përqafojmë trëndafilat 89
Mu deshën ndoshta njëqind vjet 90
Plepi në qytetin tim 91
Mes kësaj shumësie gjysmash 92
Nëse veprojmë ndryshe 93
Alepo në hartën e turpëruar të botës 94

Katalogimi në botim – **(CIP)**
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Telat e shirave / Adem Zaplluzha. – Prishtinë : "Trend", 2017. – 110 f. ; 21 cm.

Shënime për autorin : f. 96-106

ISBN-978-9951-694-86-5